



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 11

Prishtinë, më 22 qershor 2011, në orën 11: 30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Sasha Gjokiq, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Aurora Bakalli dhe Gëzim Kelmendi.

Mungoi: Nazane Breca.

Të pranishëm: Nenad Rashiq- ministër i MPMS, Fadil Rracaj- MPMS, Shpresa Haxhijaj - administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Shefki Kastrati- NDI dhe Ukë Gashi- Presidenca e Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 15.06.2011,**
- 3. Takim me ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Nenad Rashiq,**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 15.06. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale e miratoi procesverbalin e datës 15 qershor 2011.

3. Takim me ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Nenad Rashiq

Fikrim Damka- E përshëndeti ministrin dhe të pranishmit e tjerë dhe tha se sipas Planit të punës, sot e kemi paraparë një takim pune me ministrin. E kemi ftuar ministrin të raportojë për projektligjet që janë në procedurë, planet dhe prioritetet e Ministrisë për vitin 2011, gjendjen në Institutin Special në Shtime. Sipas Strategjisë legjislative të Qeverisë dhe Planit të punës së Komisionit, deri në fund të muajit qershor kanë qenë të parapara disa projektligje të vijnë në Kuvend. Ftojme ministrin të na njoftojë se në cilën fazë ndodhen këto projektligje, e sidomos Projektligji për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve të UÇK –së dhe familjeve të viktimave civile të luftës.

Nenad Rashiq- Falënderoi Komisionin për ftesën. Ato që unë e konsideroj më të rëndësishme janë Ligji për vlerat e luftës dhe Ligji për skemën pensionale të financuar nga shteti. Këto dy ligje prekin dy grupe që i konsiderojmë me interes të veçantë. Ligji për vlerat e luftës është teknikisht i modifikuar dhe është në përputhje me të gjitha rekomandimet e FMN- së dhe Bankës Botërore dhe për një kohë shumë të shkurtër do të diskutohet në mbledhje të Qeverisë. Përmes Ligjit për skemën pensionale të financuar nga shteti, krijohet një formë e re e pensioneve e cila është e pranueshme. Sistemi ynë pensional është më i avancuar se ai i vendeve të rajonit (Maqedoni, Bullgari, Serbi). Kemi siguruar, si fond shtesë 24 milionë euro në vit, në të cilin janë paraparë të gjitha skemat pensionale, si pensioni bazë, kontributpaguesit, pensionistët e Trepçës. I kuptoj shumë mirë brengat e pensionistëve, por e dimë të gjithë se buxheti është i vogël. Ligji parasheh një rritje për të gjitha skemat e pensioneve, në veçanti për kontributpaguesit. Një pension kontributdhënës do të jetë 116 euro dhe ky është maksimumi absolut të cilin ne mund ta sigurojmë. Kemi obligim, për shkak të Raportit të Progresit, që deri në shtator ta bëjmë plotësim ndryshimin e Ligjit për skemën e asistencës sociale, i cili po ashtu ka kosto financiare. Ligji për fondin pensional në Kosovë është bartur nga strategjia e vitit 2010. Nuk kemi një bazë të shënimeve për numrin e të papunëve, sepse nuk e kemi një ligj i cili do të mundësonte stimulimin e atyre që paraqiten për t'u regjistruar si të papunë në zyrat komunale. Kjo kërkon kosto të madhe financiare dhe është e pamundshme të bëhet tash për tash. Pra, për të gjitha projektligjet e parapara me Strategji jemi duke punuar sipas agjendës së paraparë.

Sa i përket planeve që në Ministri i kemi, ne zhvillojmë aktivitetin tonë në politika aktive të tregut të punës, përmirësimin e shërbimeve publike, punësim etj. Projekti më i rëndësishëm për ne është punësimi. Për çdo vit përmes zyrave tona punësohen rreth 8 mijë njerëz, numër i cili nuk është i mjaftueshëm. E kemi një projekt që quhet Kosova e bukur, e që kushton rreth 5 milionë euro dhe që ka të bëjë me ndihmën e komunave për t'i rregulluar mjediset e tyre. Po ashtu kemi një projekt kemi projektin me Lux development për zbutjen e papunësisë. Por, këto nuk janë të mjaftueshme për të zbutur

papunësinë, sepse kemi një rritje ekonomike jo te mjaftueshme. I kemi 210 mijë njerëz që kërkojnë punë dhe kanë vetëm shkollimin fillor. Ulja e papunësisë është sfidë shumë e madhe. Sa i përket mundësisë së punësimit jashtë Kosovës, kemi hasur në pengesa të shumta. Tregu evropian i punës është i mbyllur për neve, përveç rasteve individuale të cilat mund të depërtojnë.

Instituti special në Shtime është një problem shumë kompleks që është vështirë të zgjidhet. Më 1999 kanë qenë 350 pacientë me diagnoza të ndryshme. Njerëzit me çrregullime të tilla kanë nevojë të shumta. Që nga viti 2001 Ministria e ka bërë një masterplan për mbrojtjen e kësaj kategorie të njerëzve. Janë ndërtuar 2 shtëpi, në Shtime dhe Graçanicë, gjë e cila ka mundësuar të ndahen fëmijët nga të rriturit. Kemi vënë gjithmonë theksin të bashkimi familjar dhe kemi stimuluar familjet që t'i marrin anëtarët e tyre në shtëpi, pra të bëhet bashkimi familjar. Shtëpitë e komunitetit janë një projekt në të cilat parashihet të vendosën nga 10 njerëz në to dhe do të mundësohej një punë më e mirë. Deri më 2006 kemi ndërtuar 7 shtëpi të komunitetit në komuna të ndryshme.

Në planet tona kemi paraparë ndërtimin e qendrave ditore për njerëzit me nevojë të veçanta, në të cilat ata mund të qëndrojnë gjatë ditës.

Time Kadriaj- Konstatoi se është faji i ministrit dhe Ministrisë që nuk janë proceduar me kohë Ligji për kategoritë e luftës dhe Ligji për skemat pensionale. A i keni takuar grevistët dhe a ju keni dhënë informacione se kur do të vijë ligji? A do të rritet pensioni për kategoritë e pensionistëve kontributdhënës? A ka Ministria prioritete të punësimit dhe a ka partnerë që e ndihmojnë punësimin në Kosovë? Ligji për deputetët i mundëson deputetët që pas përfundimit të mandatit të kthehet në vendin e punës dhe ju këtë nuk e keni bërë me kryeinspektorin e punës dhe në të njëjtën kohë e keni punësuar një kryeinspektor tjetër.

Flora Brovina- Tha se Ligji për veteranët është sjellë edhe në mandatin e kaluar. Unë i kam vizituar veteranët dhe invalidët grevistë dhe mund të them se ata janë pak të manipuluar. Mendoj se do të ishte mirë formimi i fondit për sigurime shoqërore, që do të mundësonte zbatimin e Ligjit të punës. Çka po bëni rreth pensioneve të bashkëqytetarëve tanë nga Zvicra? Ka vërejtje rreth zbatimit të Ligjit të punës, sidomos për korporatën Bechtel- Enka. A keni ju informata të tilla? Mendoj se tregu i punës në Evropë ka nevojë për punëtorë por duhet të bëhen marrëveshje me këto shtete.

Salihe Mustafa- E pyeti ministrin se a trajtohen punëtorët shëndetësorë të Institutit special në Shtime, sikur edhe të gjithë punëtorët e tjerë shëndetësorë dhe çka do të bëni për rregullimin e kësaj çështjeje? A ka ndonjë rast që është i vendosur në Institutin special në Shtime, por që ka familje? Dihet se ka pak inspektorë të punës, por dua të di se si është bërë shpërndarja e tyre nëpër komuna?

Aurora Bakalli- Konstatoi se është nënçmim që për veteranët të thuhet se ata janë të manipuluar. Pa një angazhim të madh të Qeverisë është e pamundshme të zbutet papunësia. Stafi i Institutit special duhet të privilegjojen, sepse bëjnë një punë të madhe. Përkundrazi, ata nuk trajtohen as si punëtorët e tjerë shëndetësorë. Nevojiten hapa të duhur në drejtim të përmirësimit të gjendjes në këtë Institut.

Gëzim Kelmendi- E pyeti ministrin se sa do të jetë pensioni për pensionistët jokontributdhënës dhe kontributdhënës? A do të ishte ide e mirë që të rritet numri i inspektorëve të punës dhe kjo të bëhet duke u bazuar në financimin që do të vije nga legalizimi i të punësuarve që, tash për tash, fare nuk janë të lajmëruar si të tillë? Do të ishte mirë që të punësuarit ta kenë një mundësi për t'i lajmëruar shkeljet e të drejtave të tyre të punës dhe që ky lajmërim të ishte konfidencial.

Bahri Thaçi- E pyeti ministrin se çka do të ndërmerrni që të hapet tregu evropian i punës për punëtorët nga Kosova? Problemi i papunësisë është shumë i vështirë të zgjidhet. Pa investime të huaja nuk mund të mendohet për zgjidhjen e këtij problemi. Aq më tepër kur i kemi prishur marrëveshjet me FMN. Qendrat për qëndrim ditor nuk kanë pasur qëndrueshmëri në funksionimin e tyre. Sa ka rëndësi që nxirret një ligj, po aq rëndësi ka edhe monitorimi i tij. Ligji i punës nuk është duke u zbatuar as në institucione publike, sidomos neni për pushimin e lehonisë. A i përcjellni ju raportet e Inspektoratit të punës?

Nenad Rashiq- Duke u përgjigjur në pyetjet e deputetëve tha që unë nuk jam kompetent të komentoj për problemet politike të Ligjit për vlerat e luftës. Qëndrimet e pensionistëve janë të forta dhe ne nuk kemi mundësi që t'i zgjidhim problemet se si dëshirojnë ata, sepse nuk kemi mundësi financiare. Numri i inspektorëve të punës është shumë i vogël, por mundohemi që të jemi efikas në punë. 80% e punëdhënësve nuk e dinë se çka përmban Ligji i punës. Nuk duhet të marrim vetëm masa represive sepse mund të kemi kundërefekt. Gjendja në Institutin special në Shtime është e rëndë. Kemi pasur edhe shkurtime buxhetore. Sa i përket sigurimeve shoqërore, ne do të diskutojmë dhe do të gjejmë një zgjidhje të pranueshme. Për problemin me pensionet e Zvicrës jam angazhuar që në momentin që e kam kuptuar se ai problem ekziston. Ne i kemi 7 komisione inspektuese në korporatën Bechtel- Enka dhe, përveç lëndimeve në punë, asnjë shkelje e Ligjit nuk është raportuar zyrtarisht nga atje. Kur e thashë se tregu evropian i punës është i mbyllur, mendova se ne si institucione nuk mund të nënshkruajmë ndonjë marrëveshje për punësim stinor, ndërkaq rastet individuale mund të depërtojnë. Kufizime të tilla, sa i përket tregut të fuqisë punëtore, kanë edhe disa nga shtetet anëtare të BE-së, si p.sh. Rumania dhe Bullgaria.

Jemi në proces të harmonizimit të pagave të punëtorëve shëndetësorë të Institutit Special në Shtime, me punëtorët e tjerë shëndetësor dhe, më së voni, kjo do të bëhet prej fillimit të vitit të ardhshëm. Për fëmijët e braktisur ne nuk kemi formë detyruese ligjore për prindërit që t'i kthejnë ata fëmijë përsëri në familjet e tyre.

Numri i inspektorëve nëpër komuna është shumë i vogël, pra i kemi vetëm 50 inspektorë, ndërkaq kemi 37 komuna. Gjatë rishikimit buxhetor do të insistoj që të rritet numri i inspektorëve. Për politikën e punësimit kemi vetëm 200 mijë euro për një vit dhe kjo bën të pamundur të bëhet diçka më shumë në këtë drejtim. Me ligjin e pensioneve ne u kemi dhënë përparësi pensionistëve kontributdhënës ndaj atyre që do ta gëzojnë vetëm pensionin bazë. Kemi numër të madh të pensionistëve dhe me këtë ligj duam t'u tregojmë se nuk janë shtresë e harruar e popullatës. Diskrecioni i atyre punëtorëve që denoncojnë shkeljet e të drejtave të tyre garantohet nga ana jonë. Për Qendrat ditore është vështirë të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme, sepse nuk mund të punësojmë punëtorë të tjerë. Pushimi i lehonisë tashmë është harmonizuar dhe ky pushim do të vlejë edhe për shërbyesit civilë.

Fadil Rracaj- Me kërkesën e ministrit, sqaroi se projektligjet e Ministrisë janë proceduar me kohë. Arsyeja se pse është refuzuar kërkesa e kryeinspektorit për t' rikthyer në vendin e tij të punës, është se ka kolizion të ligjit për deputetët dhe ligjit për shërbimin civil. Janë realizuar 6 rekomandime nga 8, sa ka nxjerrë Kuvendi i Kosovës lidhur me këtë çështje. Nuk është realizuar rekomandimi për një takim të nivelit politik ndërmjet dy vendeve dhe rekomandimi për legjislacionin për sistemin pensional. Është miratuar rregullorja për pushimin e lehonisë për shërbyesit civilë.

4. Të ndryshme

Salihe Mustafa- Informoi anëtarët e Komisionit se është gati amendamenti i Projektligjit për Organizimin Sindikal.

Mbledhja përfundoi në orën 13:10.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka